# K O N T R A T E

## E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EUROPA" SHPK

### EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA

Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.8.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" dhe ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe nenit 64 te ligjit 7667 date 28.1.1993 per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregtar me vullnetin e tyre te lire te shprehur ne nenshkrimin e kesaj kontrate ortaket ;

1. Vangjel Rula, i biri i Dhimitrit, lindur ne Bilisht, dtl. 1948, banues ne Elbasan.
2. Thanas Rula, i biri i Dhimitrit, lindur ne Korce dhe banues ne Elbasan, dtl. 1954, banues ne Elbasan.

Deklarojne se kane lidhur si me poshte vijon, kontraten e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "EUROPA" SH.P.K

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EUROPE" eshte :

- Ne fushen e projektim, ndertim, montim te objekteve social e industriale, tregtimine te gjitha llojeve te materialeve, pajisjeve e lendeve te para, eksportimin e importimin te te gjitha llojeve te mallrave te ndryshme, tregtim te te gjitha mallrave te ndryshem me shumice e pakice brenda dhe jashte vendit.

- Te kryeje te gjitha veprimtarite tregtare, industriale, financiare, te pasurive te tundshme dhe te patundshme perfshire pjesemarrjen ne shoqeri shqiptare dhe te huaja; si dhe pjesemarrjen ne shoqeri te perbashketa, marreveshje me persona fizik e juridik shqiptar apo te huaj, gjithmone keto te lidhura me objektin e kesaj shoqerie.

SELIA E SHOQERISE

- Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EUROPE" eshte ne Elbasan. Ajo gezon te drejten te krijoje ose te mbylle ne Shqiperi apo jashte vendit filiale, perfaqesi apo seli te tjera.

JETEGJATESIA E SHOQERISE

Jetegjatesia e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EUROPE" Sh.p.k. eshte mbi 10 vjet.Palet kane te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve kohezgjatja mund te nderpritet para afatit ose te kerkojne rizgjatjen e saj prane Regjistrit Tregtar Tirane.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise "EUROPE" sh.p.k. eshte 100.000 LEKE lireta, kuotat e te cilit jane te ndara ne kete menyre te barabarte midis dy ortakeve nga 50 % secili:

Kapitali shoqeror mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilanci duhet aprovuar bnrenda 4 muajve te ardhshem
Shoqeria e fillon aktivitetin ne momentin e regjistrimit te Regjistrit Tregtrar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise jane ;

- Asambleja e ortakeve
- Keshilli Administrativ
- Komisioni i revizionimit.

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar EUROPE shpk.

Te drejtat e paleve ne kete kontrate jane si vijon ;

- Te marrin pjese ne administrimin dhe drejtimin e shoqerise
- Te marrin pjese ne ndarjen e fitimit sipas kuotave respektive dhe ne perputhje me statutin;
- Ne baze te kuotave qe kane, te marrin pjese ne shperndarjen e aktivit qe do te rezultoje mbas daljes se bilancit te likuidimit, ne rast se mbyliet shoqeria.

Detyrimet e paleve ne kete kontrate jane si vijon ;
- Te derdhin pjesen e tyre ne kapitalin baze, sikurse parashikohet ne kapitalin fillestar te kesaj shoqerie.
- Te marrin pjese ne drejtimin dhe administrimin e shoqerise, ne perputhje me statutin;
- Te ruaje sekretin me gjithcka qe ka te beje me aktivitetin e shoqerise.

Ortaket kane te drejte te heqin dore prej kesaj kontrate sipas normave te statutit, duke lajmeruar te pakten nje vit me pare ortakun tjeter.

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te rrjedhin nga kjo kontrate, ne rast se nuk do te mund te zgjidhen me vullnet te mire, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane ( sipas kompetencave) pa mohuar te drejten e kalimit te ceshtjes prane arbitrazhit Nderkombetar ne Gjeneve te gjykimit sipas ligjit zviceran.

Modifikime te mundshme apo shtesa ne kete kontrate, do te kene vlere dhe do te zbatohen vetem ne rast se kryhen me shkrim te firmosura nga te dy palet, ose po te dale nevoja te kene autorizimet perkatese nga ana e autoriteteve kompetente.

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me kontraten e punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen dispozitat e Kodit te Punes. Kjo eshte e njejte edhe per filialet, zyrat e perfaqesise apo agjencite.

Administratore do te jete z. Vangjel Rula.

O R T A K E T

Vangjel Rula

Thanas Rula

# S T A T U T I

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "EUROPE" SHPK

### KREU I

### EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA

### NENI 1

### EMERTIMI

Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.8.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" dhe ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe nenit 64 te ligjit 7667, date 28.1.1993 per regjistrimin e shoqerave ne regjistrin tregtar me vullnetin e tyre te lire te shprehur ne nenshkrimin e kontrates qe i bashkohet ketij statuti, ortaket :

1. Vangjel Rula i biri i Dhimitrit, lindur ne Bilisht, dtl. 1948, banues ne Elbasan.
2. Thanas Rula, i biri i Dhimitrit lindur ne Korce dhe banues ne Elbasan, dtl 1954, banues ne Elbasan.

Ne kerkuesit kemi krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar EUROPE SH.P.K

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "EURÒPE" SHPK fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykaten e Rrethit Tirane. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e Legjislacionit Shqiptar ne fuqi dhe ato te akteve te saj themeluese, si ky statut dhe Kontrata qe i bashkohet dhe qe perben nje pjese te pandare te saj.

### NENI 2

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EUROPE" eshte :

Ne fushen e projektimit, ndertimit, montimit te objekteve social e industriale, tregtimin te gjitha llojeve te materialeve.

paisjeve e lendeve te para, eksportimin e importimin te te gjitha llojeve te mallrave te ndryshme, tregtim te te gjitha mallrave te ndryshem me shumice e pakice brenda dhe jashte vendit.

Te kryeje te gjitha veprimtarite tregtare, industriale, financiare, te pasurive te tundshme dhe te patundshme perfshire pjesemarrjen ne shoqeri shqiptare dhe te huaja, si dhe pjesemarrjen ne shoqeri te perbashketa, ne bashkepunim me persona fizik e juridik shqiptar apo te huaj, gjithmone keto te lidhura me objektin e kesaj shoqerie.

Aktiviteti i shoqerise shtrihet ne te gjithe territorin e Shqiperise dhe jashte saj. Qendra e cdo ortaku eshte e regjistruar ne librin e shoqerise EUROPE SHPK

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

- Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EUROPE" eshte ne Elbasan. Transferimi i mundshem i selise se shoqerise duhet te vendoset nga Asambleja e ortakeve te Shoqerise. Ajo gezon te drejten me vendim te keshillit Administrativ dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar te krijoje ne Shqiperi apo jashte vendit filiale perfaqesi apo dege te tjera mbeshtetur ne kritere te miratuara nga organet perkatese , si dhe te legjislacionit te vendit ku ato hapen.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Jetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar EUROPE sh.p.k eshte mbi 10 vjet. Ajo mund te shperndahet perpara kesaj date me vendim unanimitet Asambleise se ortakeve ose kur vertetohen rrethana te tilla, kur shperndarja e saj urdherohet ne menyre te plote nga ligji.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT OSE PJESET

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise "EUROPE" sh.p.k. eshte 100.000 LEKE, kuotat e te cilit jane te ndara ne kete menyre te barabarte nga 50 % secili.

Kapitali base (fillestar) mund t'i kthehet ortakeve vetem ne castin e likuidimit te shoqerise apo ne castin e terheqjes se kuotes se ortakut, duke mbajtur parasysh edhe rezultatet e aktivitetit, sikurse percaktohet ne statut dhe ne kontraten e themelimit.

te lena peng , pengmarresi do te pranohet si person te cilit i jane transferuar kuota te kapitalit themeltar te shoqerise, me perjashtim te rasteve kur shoqeria preferon t'i ribleje keto pjese e te deklaroje zvogelimin eventual te kapitalit te saj themeltar.

## KREU III

## ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA E ORTAKEVE

### Neni 10

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar EUROPE SHPK. Vendimet e saj ne perputhje me ligjin dhe normat e ketij statuti jane te detyrueshme per te gjithe ortaket , duke perjashtuar te drejten e tyre te ankimit kunder veprimeve qe ata i cmojne te demshme per interesat e tyre.

### Neni 11

Organi vendimor i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EUROPE"sh.p.k. eshte Asambleja e Ortakeve. Asambleja e Ortakeve zgjedh Keshillin Administrativ. Keshilli Administrativ zgjedh administratoret qe do ta perfaqesojne ne marredhenie me te tretet. Asambleja mblidhet ne mbledhjet e saj te zakonshme e te jashtezakonshme.Administratore do te jete z. Vangjel Rula.

Ne mbledhjet e zakonshme ajo shqyrton e vendos per ceshtje te tilla si emerim apo shkarkim i administratorit, eksperte dhe kontabilist te autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore, ndarja e fitimit etj.

Ne mbledhjet e saj te jashtezakonshme Asambleja e Ortakeve vendos per ceshtje te tilla si, ndryshimet e statutit, zvogelimin e kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e kohes se veprimtarise se Shoqerise apo likuidimi i saj.

### Neni 12

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "EUROPE" sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejta e detyrimet. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore e jashtekontraktore brenda kapitalit te saj. Ortaket bartin rrezikun per veprimtarine e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te kapitalit te investuar ne rastin e krijimit te shoqerise.

Ortaket qe zoterojne te pakten 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise mund te kerkojne gjyqesisht caktimin e nje eksperti kontabel per verifikimin e nje operacioni apo te veprimtarise se shoqerise ne teresi.

Shoqeria merr persiper vete te drejta e detyrimet.

## Neni 13

Shoqeria drejtohet nga nje ose disa administratore qe duhet te jene persona juridik si dhe mund te jene ortak ne shoqeri ose jo.Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderojne te nevojshem per arritjen e qellimeve te shoqerise, ata kane te drejta midis te tjerave te blejne e te kembejne pasuri, te lidhen me shoqeri te tjera te ngritura ose qe do te krijohen si brenda ashtu dhe jashte shtetit, duke siguruar pjesemarrje per qellimet e veprimtarise ekonomike .Emerimi i nje administratori behet per nje kohezgjatje prej tre vjetesh financiare, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem.
Ne marredheniet me ortaket ose me te tretet, administratoret kane te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise e ne emer te saj. Administratoret jane pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit, ose per fajet e kryera gjate administrimit.

## Neni 14

Ne rast nevoje ose kur e kerkon ligji, kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar nga ortaket e shoqerise. Ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres nga eksperti kontabel, ky i fundit mund te shkarkohet, shkarkimi i te cilit vendoset me te njejten menyre si dhe emerimi i tij.

## Neni 15

Shoqeria administrohet nga Keshilli Administrativ, i perbere nga nje numer tek i ndryshueshem anetaresh, nga tre deri ne pese, te emeruar dhe te shkarkuar nga asambleja e zakonshme e ortakeve, ata qendojne ne detyre deri ne heqjen e tyre nga asambleja, qofte edhe pa te drejte, apo per efekt doreheqjeje.

Ne rast se hiqen ose pushojne se funksionuari me shume se gjysma e administratorive, ata qe mbeten duhet te mbledhin sa me shpejt asamblene e ortakeve per te proceduar lidhur me rinovimin e te gjithe Keshillit Administrativ.

I takon asamblese se zakonshme te ortakeve te vendose edhe per numrin e anetareve te Keshillit Administrativ.

Secili anetar i Keshillit Administrativ gezon te drejten e nje vote te vetme.

Per t'i bere te vlefshme vendimet e Keshillit Administrativ kerkohet prania e shumices se anetareve, pavaresisht nga prania e revizoreve. Vendimet merren me unanimitet.

Keshilli administrativ gezon fuqi te medha per administrimin e zakonshem e te jashtezakonshem te shoqerise, pa asnje perjashtim apo rezerve, me perjashtim te rasteve te parashikuara ne kompetence te Asamblese se ortakeve.

Ky keshill ushtron edhe kompetencat qe vijojne :

- miraton planet dhe projekt bilancet qe do t'i paraqiten Asamblese.

- propozon ndryshimet e kapitalit baze qe do t'i paraqiten Asamblese;

- percakton dhe zgjedh kriteret e kontabilitetit dhe te administrimit te shoqerise ;

- harton kontratat dhe brenda shoqerise, ne vecanti kontraten me personelin ;

- percakton numrin e drejtuesve, i emeron ata, cakton detyrat dhe trajtimin ekonomik te tyre si dhe marredheniet e punes:

- krijon, ndryshon dhe prish organizma te tjere qe mund te jene te nevojshem per realizimin e objektit te funksionimit te shoqerise ;

- ben propozime te tjera ne asamble lidhur me perdorimin e fondeve te vecanta, shperndarjen e fitimit si dhe mbylljen e mundshme te shoqerise;

- percakton njesi te tjera te mundshme te shoqerise ( filiale etj.).

Neni 16

Kuotat e shoqerise jane te transferueshme sipas procedures qe vijon ;

Ortaku qe ka per qellim t'ia dorezoje pjeserisht ose plotesisht kuoten e tij ortakut tjeter ose me konsensus unanim te ortakeve te tjere i ofron kuoten e tij ortakeve te tjere nepermjet nje letre te rekomanduar ortakeve dhe Keshillit Administrativ duke treguar cmimin e kerkuar.

Ortaket e tjere kane te drejte te blene kuoten e ofruar ne proporcion me pjesemarrjen perkatese ne shoqerise, duke e bere te ditur kete fakt brenda 30 diteve nga marrja e ofertes, me te mbaruar nje afat te tille, konsiderohet qe kane hequr dore nga bleria. Ne rastin e refuzimit nga ana e ortakeve te tjere per te ushtruar pjeserisht ose plotesisht te drejten e zoterimit, ortaku terheqes mund t'ua shese te treteve kuoten , por me nje cmim jo me te vogel se ai i bere ne oferten per ortaket e tjere.

Neni 17

Te gjithe te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise, duke vazhduar kete detyre edhe pas largimit te tyre nga kjo shoqeri.

KREU IV
SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 18

Shperberja e shoqerise mund te vij ne cdo kohe dhe per cfaredo

shkaku si per humbje te kapitalit te shoqerise, pamundesi veprimtarie, ose me vendim te Asamblese . Nè kete rast ata vendosin mbi menyrat e likuidimit dhe caktojne nje ose me shume likuidatore, duke i percaktuar detyrat. Keto kujdesen qe ne radhe te pare te shlyhen detyrimet qe shoqeria u ka personave te trete.

Neni 19

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje Asambleja e Ortakevé, si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen nxirret vete statuti.

Neni 20

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me kontraten e punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislácionit shqiptar te punes. Kjo eshte e njejte edhe per filialet, zyrat e perfaqesise apo agjencise.

Ky statut firmoset rregullisht nga ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EUROPE".

O R T A K E T

Vangjel Rula

Thanas Rula